


Nr. 2/10 dt. 22.02.2010
PRISHTINË

Për: Z.Ali Hamiti/Kryesues i Bordit ZRE
Z.Fadil Qitaku/Kryesues i Bordit KEK
Z.Arben Gjukaj/UD-Drejtor Menaxhues KEK

Cc: Znj.Justina Pula Shiroka/Ministër-MEM
Z.Ahmet Shala/ Ministër-MEF
Z.Ramadan Sejdiu-MEF/NjPMNP

nr. 034110
data 22.02.10

Z.Mahir Jagcilar/ Ministër MMPH

Cc kopje: Z.Hashim Thaqi/Kryeministër
Z.Hajredin Kuci/Zav. Kryeministër-Kryesues i Task Forces se Ujerave

Nga: Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS)

Lënda: REAGIM NDAJ KËRKESËS SË KEK-ut PËR NGRITJEN E
TARIFAVE TË ENERGISË ELEKTRIKE

NJOFTIM: Kompanitë Publike të Ujësjiellësve të Republikës së Kosovës para kolapsit
financiar për shkak të ngritjes së vazhdueshme të tarifës së energjisë elektrike

Në mbledhjen e Bordit të SHUKOS-it të mbajtur me 18.02.2010 u shpreh shqetësimi për ngritjen e vazhdueshme të tarifave të energjisë elektrike për ujësjiellësit që po ndikon në përkeqësimin e situatës financiare të kompanive të ujit me çfarë do të reflektohet në shërbimet tona ndaj konsumatoreve. Nga ky takim SHUKOS-i ka dale me një kërkesë drejtuar institucioneve për një tarifë të veçantë të energjisë elektrike ose të subvencionohet një pjesë e shpenzimeve të energjisë elektrike për ujësjiellësit e Kosovës.


Rritja e vazhdueshme e energjisë elektrike gjate viteve të kaluara ka shkaktuar në Kompanitë Publike të Ujësjiellësve të Kosovës një gjendje të rëndë financiare. Kërkesa e tanishme e KEK-ut për ngritjen e tarifës së energjisë elektrike nëse aprovohet nga ZRE Kompanitë Publike të Ujit do t'i vente në një situatë jashtëzakonisht të rëndë financiare që do të reflektonte në mosmbajtjen e nivelit të tanishëm të shërbimeve dhe pamundësinë e pagesës së rregullt të energjisë elektrike.

SHUKOS-i ju është drejtuar shumë herë me shkrim KEK-ut dhe ZRE qe ujësjiellësit për shkak të natyrës specifike qe kanë ku shërbimi i ujit ndikon në shëndetin e popullatës të kanë një tarifë të veçantë ose të subvencionohen nga institucionet si është rasti i ujësjiellësve të tjerë në rajon në mënyrë që të mundësohet një funksionim normal i këtyre kompanive publike. Fatkeqësisht, kërkesat tona asnjëherë nuk janë marrë parasysh dhe në ujësjiellësit publik paguajmë sot si bizneset fitimprurëse.

Nëse propozimi për rritje të tarifave aprovohet nga ZRE ujësjiellësit do t'i sillte para një kolapsi andaj kërkohet nga institucionet përgjegjëse duke përfshirë edhe KEK-un të parandalojnë ngritjen e tarifave të energjisë elektrike dhe të marrin parasysh kërkesat e mëhershme të Ujësjiellësve të Republikës së Kosovës.

Ujësjiellësit Publik të Kosovës kërkojnë takim urgjent të Task Forcës së Ujërave ku do të diskutohet çështja e energjisë elektrike.

Me respekt,
Msc.Nadire Bejtullahu Vitija
Drejtor Menaxhues
SHUKOS



Msc. Skender Bublaku
Kryetar i Bordit SHUKOS
KE / KUR "Prishtina"

